



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 4062/17 Prot.

Pogradec, më 11 . 11 . 2025

VENDIM

NR. 108, DATË 10.11.2025

MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 31.10.2025 TË
KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 31.10.2025, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

KËSHILLI I BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 31.10.2025 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

1.Miratuar me 24 vota

2.Vota Pro 24

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 11.11.2025



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 31.10.2025

ORA : 11:00

JANË PREZENT 26 KËSHILLTARË

PROTOKOLLI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC
DATE 31.10..2025 , ME KËTË REND DITE.

1. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
2. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. **Projekt – Vendim :** Miratimi i Procesverbalit të datës 25.09.2025.
4. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 25.09.2025.
5. **Projekt – Vendim:** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për muajin Shtator 2025.
6. **Projekt – Vendim :** Për miratimin e fondeve për investime të ndryshme.
7. **Projekt – Vendim:** Për një shtesë në vendimin nr.15, datë 01.03.2017 “Për miratimin e orareve dhe stacioneve për linjat rrethqytetase.”
8. **Projekt – Vendim:** Për miratimin paraprak të hartimit të Planeve të menaxhimit Ekonomitë Pyjore Qafë-Panjë dhe Guri I Nikës.
9. **Projekt – Vendim:** Për rishqyrtimin e vendimit nr. 86, datë 25.09.2025, “Përmiratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistikë dhe sportivë”, i kthyer me shkresën e prefektit të qarkut korçë nr. 900/1 prot, datë 08.10.2025, me lëndë, “Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të këshillit”.
10. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Pogradec, për vitin 2026.
11. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 35.5200 ha, të ndodhura në Njësinë Administrative Cërravë që mund të jepen me qera.

12. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 37 ha dhe 6620 metra, e ndodhur në njësinë administrative Bucimas dhe Trebinjë që mund të jepen m qira.
13. **Projekt – Vendim:** Mbi dhënie shpërblim për nxënësit ekselentë që kanë përfunduar arsimin e mesëm në vitin shkollor 2024-2025.
14. **Projekt – Vendim:** Për një shtesë në vendimin nr 56, datë 19.06.2023 “ Për krijimin e komisioneve të përhershme të këshillit të bashkisë Pogradec”
15. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e dhënies në përdorim të fondit pyjor/kullosor, sipërfaqja 45000 m2 për qëllime ndërtimin e parkut eloik në Bashkinë e Pogradecit subjektit “RENX ALBANIA” shpk.
16. Të tjera.



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 31.10.2025

Znj.Kryetare : Përshëndetje.

Vazhdojmë me axhendën. Meqë është Tetori Rozë ne morëm një nisëm vajtëm në të gjitha zonat e largëta për të diskutuar me gratë e atyre zonave dhe për tju mundësuar mamografinë. Do vendosim mjetin e transportit për ti sjelle në vendin që zhvillohet mamografia.

kalojmë në një pikë tjetër që mua më shqetëson, e kam fjalën për Këshilltarët kam vënë re që nga fundi i mbledhjes ju filloni dhe largoheni, nga mbledhja e rradhës do fillojme të marim masa, po ju lexoj nenin dhe masat që do të meren për cdo Këshilltar.

Vazhdojmë me rendin e ditës, lexojmë rendin e ditës.

Nga 15 pikat e rendit të ditës,pika 12 kalon në konsultim public hiqet nga rendi i ditës. Duhet të vendosim për pikën 15 kalon në konsultim public apo jo.

Mendimin tim do e jap në fund.

1.Miratimi i Rendit të ditës.

E mer fjalën Z.Torra për pikën 15

Z.Torra : Nuk mendoj ta kalojmë në Knsultim Publik është marë miratimi nga Ministria përkatëse

Znj.Topa: Edhe pse nuk bën sens duhet bërë një Konsultim Publik sepse nuk është bërë nga ne por nga Bashkia.



Z.Torra është njëloj si UANI që do vijë të vejë një antenë dhe ne nuk e ndalojmë dot mos vënien e antenës në Pogradec.

Znj. Topa: Këshilli Bashkiak për sa kohë ka arrdhur si Projekt-Vendim pa emra të përvecëm të asaj kohe se ka kryer Këshilli konsultim public.

Znj.Këshilltare: Përfundimi.

Znj.Topa: Përfundimin nuk e nxjerr unë por e nxjerrim të gjithë së bashku se unë nuk përfaqësoj shumicën.

Znj.Kryetare e vendosi komisioni.

Znj.Topa : Jo nuk e vendosi komisioni se atë ditë në komision isha vetëm unë dhe unë nuk përfaqësoj komisionin. Ja ku jemi le ta vendosim të gjithë së bashku.

Znj.Kryetare: ja japim fjalen.

Znj. Shuli: Unë nuk mbaj mend që në Këshillin Bashkiak të mëparshëm të jetë kryer një Konsultim Publik.

Znj. Kryetare : Unë po ju a cilësoj që ka qënë një projekt që jepet për studim me në vit kontratë qeraje të mos l ngatërojmë gjërat. Ndryshe është për studim pastaj ne të vazhdojmë ta japim me qera, unë kështu e komentoj.

Znj Shuli: Për të bërë një Konsultim Publik përpara një fakti të kryer mua më duket absurde.

Znj Kryetare: Ku e shikon ti faktin e kryer.

Znj Shuli: Këtu ne shofim që është marë lishenca dhe do kryhet ndërtimi.

Znj Topa: Arsyeja pse ne nuk ja japim kush është, ti shkojmë komunitetit me një fitues kjo është ngërci. Sepse nuk është bërë që në fillim ashtu cid duhet.

Znj.Kryetare ja jep falën Z. Male.



Z.Male: Unë I qëndroj këti argument që ne duhet të bëjmë Konsultim Publik me banorët dhe unë kam folur me Kryeplakun e fshatit dhe ne na thanë që është bërë Konsultimi Publik dhe mua nuk më konsulton dicka e tillë.

Z.Torra: Nuk po flasim për Petrushën por po flasim për Udënishtin.

Z.Male: të më falni e kam ngatërruar unë atëhëre, ndjesë gjithsesi edhe këtu pranohet që nuk ka ndodhur një konsultim me banorët. Unë I qëndroj këti fakti që të bëhët konsultimi public dhe banorët të vihen në dijeni.

Z.Torra ne me banorët e kemi bërë konsultimin por nuk kanë qënë pjestarët e këshillit present jo që nuk ka ndodhur ky konsultim public.

Znj.Kryetare: Po pra ka qënë bashkia ne këtë konsultim jo Këshilli dhe mund të shtoj se e kishin bërë shumë mirë ishin të gjitha prezantimet edhe fotot.

Znj. Topa: Dhe vendimi që është marrë në 2021 është të vihet në përdorim.

Znj.Kryetare: Është për një vit.

Znj.Topa: Nuk ka rëndësi se për sa është lenë, të jëtë për sat të dojë. Ne e dimë shumë mirë që këtu kemi konfliktin e pronësisë që ndoth rëndomtë për mua duhet të ishte bërë që asaj kohe ne nuk I kemi hyrë asnjëherë afatit dhe për këtë arsye jemi në këtë ngërc sot. Por që Këshillit Bashkiak I duhet dokumentacioni ajo është absolute , por sot jemi para faktit edhe duhet ta zgjidhim ne si Këshilli

Znj.Kryetare: Do flasi dikush tjetër.

Znj.Prifti: I referohem seminarit që ne ndoqëm në Korçë dhe atyre udhëzimeve që ne morëm dhe absolutisht jam që të bëhët konsultim. Ne duhet ti referohemi ligjit.

Znj.Kryetare: Personalisht po jap mendimin tim dhe kam bërë një argument Ligjor për bërjen e këtij konsultimi. Projekt- Vendim: Për miratimin e dhënies në përdorim të fondit pyjor/kukullosor, sipërfaqia 45000m2 për qëllime ndërtimin e parkut eloik në Bashkinë e Pogradecit subjekti " RENEX ALBANIA" shpk.

Të lutem Z.Bojku të bashkangjitet në procesverbal.



Është e domosdoshme zhvillimi i procesit të konsultimit public pavarësisht që Bashkia ka zhvilluar një të tillë. Nga interpretimi i këtyre dispozitave mendoj të kryhet konsultimi public me banorët e zonës, përpara miratimit të këtij vendimi. Kërkohej që vendimarrja e Këshillit Bashkiak të bëhet në transparencë.

Atëherë unë mendoj ta hedhim në votim, kush është të qëndrojë në axhendë?

Znj.Gjoshe: Do ishte më e mira të bëhet pyetja kush është dakort të kalojë në konsultim public dhe të votojmë kalon ose jo.

Znj.SHuli: nëse duhet të kalojë në konsultim public lere ashtu sic është.

Znj.Kamolli: Jo do votohet, do votojë secili kush është pro.

Z.Male: A vendosi komisioni?

Znj.Kryetare: jo nuk vendosi komisioni.

Znj. Topa: Jo nuk vendosi komisioni se unë isha vetem dhe nuk mund të vendos une në emer të të gjithëve.

Znj.Kryetare : Të hidhet në votim.

Znj.Kryetare: Kemi dy shtesa që i votuam në komisionet.

. Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025

.Për akordimin e ndihmës financiare për familjen e Z.Fatos Sulka, për mbulimin e shpenzimeve të varrimi, për humbjen e jetës së bashkëshortes Shpresa Sulka.

Kemi edhe dy pika që na i sollën sot.

."Për miratimin në parim të dhënies në përdorim, të tubacioneve nëntokësore,për shtrirjen e linjave nëntokësore telefon,energji, tv kabllor,internet" Ky projekt – vendim erdhi dje me mail.

Z.Shyti: Do e hedhim edhe këtë në konsultim public.

Znj.Kryetare: Jo

Z.Shyti: pse jo është e njëjta me pikën 15 po nejse.

Znj.Kryetare hidhet në votim.

Vazhdojmë pikën tjetër.

. Për akordimin e ndihmës financiare,për familjen e Z. Darjo Muska,Për mbulimin e shpenzimeve të trajtimit shëndetësor.

Znj. Topa: Mar shkas sepse e kam pak për zemër sat ë mundemi të ndihmojme vogëlushen e vogel.

Znj. Kryetare lexojmë edhe njëhere pikat e rendit të ditës.

Hedhim në votim rendin e ditës me ndryshime.

U votua

Pro 23

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 31. 10. 2025

2. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.

Znj. Kryetare : Është dikush nga ne që ka konflikt interesi/
Vazhdojme nuk kemi asnje.

A handwritten signature in black ink, appearing to be the initials 'JAB' or similar, located in the bottom right corner of the page.

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 31 . 10 . 2025

3. “ Miratimi i Procesverbalit te datës 25.09.2025.

Diskutime :

Znj.Kryetare: Ka ndonjë diskutim nga Këshilltarër, vazhdojmë atëhere.

U votua

Pro 23

Kundër

Abstenim

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 31 . 10 . 2025

4.Pika : Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 25.09.2025.

Diskutime :

Lënda: Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit me Nr 900/1 protokoll.

Znj .Kryetare: lexhon vendimin.

Mbështetur në ligjin nr 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” I ndryshuar, pas verifikimit të vendimeve. 85 dhe nr.87. datë 25.09.2025 të Këshillit te Bashkisë Pogradec.

Si përfundim, rekomandojmë qe “ Qendra Multifunkionale Pogradec Sha” të hartojë një projekt-rregullore të përmisuar dhe të plotësuar për miratimin nga Këshilli Bashkiak,duke përfshirë të gjitha elementët e mësipërme,më pas Këshilli I Bashkisë Pogradec të procedojë vendimmarje.

Znj.Kryetare vazhdojmë me pikën e rradhës.



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 31.10. 2025

5.Pika: Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për muajin Shtator 2025.

Znj.Kryetare: Ja japim fjalën Znj.Ivana.

Znj.Ivana: Muajin Shtator janë rekomanduar nga fondi I ndihmës ekonomike 177 familje.

Znj Kryetare ka ndonjë diskutim.

Hidhet në votim.

Znj.Kryetare: vazhdojmë me pikë tjetër

U votua

Pro 24

Kundër

Abstenim

Miratohet Po JO



- Për miratimin e fondeve për investime të ndryshme.

Znj.Kryetare: Ja japim fjalën,Znj.Irsa Karapanca për të shpjeguar projekt-vendimin.

Znj.Irsa: Projekt-Vendimi ka të bëjë me pesë projekte që do të tenderohen për vitin 2025 dhe rimbursimi do të bëhet për vitin 2026. Dje në mbledhjen e komisioneve ka qënë prezent Z. Paskalino Ziko , Nënkryetari I Bashkisë ku ka shpjeguar tre nga objektet përkatëse .Dy objekte do ti shpjegojë Znj Besa ,Drejtoresha e Emergjencave dhe dy objektet e tjera do ti shpjegoj une. Unë nuk di specifikisht ti shpjegoj nga ana inxhinlerike por di të them që fondet për rikonstruksionin e rrugës në Rrëmënj janë gjysëm për gjysëm me Këshillin e Qarkut.Gjysëm për gjysëm jo por mund të themi 70% me 30% .Prandaj ne e fillojmë në vitin 2025 dhe fondet do I marim ne vitin 2026.Projekti është vendosur në relacion .

Znj.Prifti :Dua të di si ndahet shuma.

Znj.Irsa : Kemi të bëjmë me projekt dhe projekti do të cohet tek fondi Shqiptar I Zhvillimit. Fondi Shqiptar I zhvillimit është 80% me 20%.

Znj.Prifti ku 20 % I ka Bashkia.

Znj.Irsa: Vitin tjetër shpresojmë që do të futet objekti dhe jo projekti.

Një projekt tjetër është për Qendrën Kulturore një rikostruksion edhe shkolla 'Koli Gusho' dhe "Esat Minarolli" . Vitin tjetër presim fondet nga Ministria,për dy projektet e tjera të cilat do ti prezantojë Znj. Besa, drejtoresha e Emergjencave Civile.

Znj. Besa: Fondi I strehimit, fondi I vjelë I strehimit në masën 3% është një fond I krijuar icily nuk ka ekzistuar më përpara me vendosjen e ligjit të strehimit. Të gjitha jane banesa kolektive, investitorët janë të detyruar të paguajnë 3% të

vlerës dhe ne I kemi vjelë këtë % qoftë në vlerë monetare ose në sipërfaqe në atë object që ndërtojnë. Me këtë fond ne kemi menduar të bëjmë rikostruksionin e objektit Ish Gjeologjia me qëllim e strehimit të 6 familjeve. Pra është një fond I dedikuar ku duhet të përdoret qëllimisht për strehim. Gjithashtu një pjese e fondit do të përdoret për banorin Ylli Hysenbegasi në fshatin Starovë ku jeton në kushte të mjerueshme.

Z.Male: Folët për projektimit,por atje duhet të merni parasysh kush do e projektojë.

Znj.Besa: Cdo procedurë realizohet me tender. Për këto dy hartime që unë po flas I kemi hartuar me Specialistët e Bashkisë. Unë nuk prokuroj projekte, kurse për urbanistikën besoj që ajo do zgjidhet sipas standartit.

Znj.Kryetare: Mqs nuk ka dicka tjetër për të shtuar e hedhim në votim.

U votua

Pro 24

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po **Jo**



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 31.10.2025

-Për një shtesë në vendimin nr.15, datë 01.03.2017 "Për miratimin e orareve dhe stacioneve për linjat rrethqytetase.

Z.Shtupa : Kërkohej një orar shtesë për linjën Pogradec – Proptisht , Proptisht – Pogradec. Kjo linjë konkretisht realizon transportin e mësuesve dhe të nxënësve. Po flasim konkretisht për lëvizjen e mësuesve të Rrodokalit drejt Pogradecit . Këshilli sipas ligjit ka të drejtë të miratojë linjat dhe oraret. Me kërkesë nga shoqëria ne kërkojmë shtimin e orës 13:13.

Znj.Kryetare: Atëherë kolegë në qoftëse nuk kemi pyetje, e hedhim në votim.

U votua

Pro 24

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po JO



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 31.10.2025

8. Pika: Për miratimin paraprak të hartimit të planeve tëmenaxhimit Ekonomitë Pyjore Qafë - Panjë dhe Guri I Nikës.

Znj.Kryetare: Ja japim fjalën përfaqësuesit.

Z.Brahe: Mbas ligjit 57/20 Bashkitë janë të detyruara të bëjnë mbarshtrimin e pyjore dhe kullësore qe këto pyje të vijen në shfrytëzim të Bashkisë.

Znj. Kryetarer: Personalisht me duhet një sqarim nga ana jote . Diku në titull thotë Miratimin paraprak pastaj në titull brënda thotë miratimin e planit, më poshtë prap miratimin paraprak. Ju lutem mund të na I sqarosh këtë gjë. Unë nuk jam specialiste por shikoj që brënda tekstit ka fjali pa kuptim dhe shumë të gjata madje për të më kuptuar po ju lexoj një shëmbull. Ju lutem punojeni pak më kujdes. Ma sqaro pak këtë pjesën është miratim paraprak apo është plan.

Z.Braho: Bashkia bën miratimin paraprak dhe ne pasi kemi marë nga Bashkia këtë miratim e dërgojmë në Ministri për të marë miratimin përfundimtar.

Z.Shyti: Nuk ma ha mëndja që është kaq e rëndësishmë për të mos u votuar thjesht ndryshojmë ato pika dhe presje.

Znj. Kryetare: Nuk është vetëm për pika, nuk ka lidhje por ka shumë nevoje për ndryshim mund të vish edhe ta shohësh. Nuk ka kuptim lexon Projekt – Vendimi, dhe te koka është vendim.

Znj.Topa: Nga ana teknike nuk është I saktë, ne sot bëjmë miratimin edhe nëse dicka nuk shkon të kthehet.

Z.Male: A ka informacion Këshilli Bashkiak se si po ecën ky projekt, ne sigurisht që miratojmë por duhet të kemi dhe një informacion se si po ecin këto plane dhe e dyta ka shumë ankesa nga banorët e Mokrës për fenomenin e prerjeve të paligjshme të pyjeve. A ka inspektive, kontrole të vazhdueshme nga ana e



Ispektoriatit për këtë fenomen? E diskutuam edhe në Komision mua personalisht si qytetar edhe Këshilltar I Pogradecit nuk më intereson vetem sa u sekuestruan, por që ky fenomen të zhduket.

Z. Braho: E para ne kemi diskutuar që ato parcela që janë të shënuara dhe I përkasin fshatarëve të shfrytëzohen nga ata. E dyta ne kemi operuar për të mos ndodhur ky factor por, nuk mund të arrijmë në zhdukjen totale. Këtu meret Policia e Shtetit që ka anen ligjore për të operuar. Mesa di unë janë marë masa dhe janë kapur disa persona.

Z.Markel : Deri tani janë marë 13 masa 6 milion lek kanë marë gjobën minimale.

Z.Braho: Këto të gjitha janë mbajtur me procesverbal.

Z.Shyti: Kisha një pyetje, por nuk është personi përkatës.

Z.Gjona: Pas miratimit të planit a ju jepet e drejta banorëve të marin me qera për ti shfrytëzuar po flas nga tani dhe mbas miratimit.

Z.Markel: Ka një menaxhim dhe në bazë të këtij menaxhimi aplikohet dhe në bazë të parcelave edhe pastaj bëhet ndarja përkatëse. Drejtohesh në arkiva ku ti mer të drejten për të shfrytëzuar parcelat. Nga aty bazohemi për planin e Mbarështrimit , dhe për shfrytëzimin e druve të prerë dhe për shpërndarjen ne kopështe,cerdhe dhe shkolla.

Z.Shyti: A janë siguruar drutë për këto Institucione?

Z.Markel: Po janë siguruar. Ka një plan shpërndarje I cili është miratuar nga zyra arsimore për vitin 2025-2026.Furnizimi fillon nga data 15 tetor deri në 15mars, edhe të gjitha sekuestrot do shkojnë edhe ato për të gjitha institucionet përkatëse. Baza material ndodhet në fushën e Bashkisë ku që aty fillon shpërndarja..Shpërndarja fillon së shpejti nga java.

Z.Pikuli: Ne kemi miratuar disa plane të tjera pyjore, kemi shtuar ndonjë metër kub apo kemi pakësuar? Sa kemi shtuat?

Z.Brahe: E thamë që kemi shënuar disa parcela dhe në bazë të parcelave meret vendimi.



Z..Pikuli: Po e bëj pyetjen në formë tjetër shtuam nga ky shtim fituam apo humbëm. Ne kemi miratuar një plan.

Znj.Kryetare: Ndoshta nuk mund të përgjigjet sot dhe duhet të kishte qënë vetë përgjegjësi që ne të kishim marë një përgjigje akoma më të plotë. Për mua kjo është pyetja kryesore është plan paraprak apo është plan.

Z.Brahe : Ky është plani përfundimtar, duhet të miratohet nga ju dhe më pas të miratohet nga Ministria.

Znj.Kryetare: Ketu ka shumë për të cilësuar edhe për të rregulluar.

Znj.Marjeta: Mos bëjmë të njëtin gabim që të dërgohet edhe të kthehet mbrapa ashtu si doli herën e parë, të jemi më të përgjegjshëm.

Znj.Kryetare: Po ju lexoj nje fjali që ju të kuptoni për atë që unë po flas.

Z.Shyti: Për këtë nuk e ka fajin dy specialistat që ndodhen këtu, kërkoiin llogari atyre që kanë hartuar planin.

Znj. Kryetare: Unë nuk po them këtë, por përmbajtja është pa subjekt. Nuk e di si është afati dhe prandaj po pyes për të mos prishur punë.

Z.Brahe: Afatin e kemi të limituar sa më shpejt aq më mirë. Sepse ne nuk ndërhyjmë dot.

Znj.Topa: Të shpenzosh gjithë ato para për këtë plan,por mbledhja e radhës është pas një muaji. Por duhet të dimë edhe cfar afate kanë.

Znj.Kryetare : Dua konfirmimin tuaj per mbledhje jashtë rradhe.

Z.Shyti: Nuk është hera e parë që ne I kalojmë këto material dhe më pas I rregullojmë, por për afat kohor është mirë që ne ti kalojmë se priset goxha punë.

Znj.Kryetare: Këtu ka nevojë për shumë ndryshime jo vetëm për anën drejtshkrimore.

Znj.Gjoshe: Të rregullohet dhe ta sjellin edhe njëherë për miratim.

Znj.Nenkryetare: Eshte puna e koherencës së tekstit, nuk del kuptimi në vazhdim kur lexohet ky tekst. Nuk përcillni as edhe një lloj kuptimi. Përgatiteni edhe



silleni prap duke bërë një mbledhje jashtë rradhe për ta miratuar edhe mos ju prishim pune në afatin kohor që ju përkufizon.

Z.Braho: Do e punojmë dhe do e sjellim edhe një herë të rregulluar .

Znj.Kryetare të hidhet në votim për të risjellë edhe njeherë Projekt- Vendimin dhe të mblidhemi për mbledhje jashtë rradhe. Të gjithë që do ngrini kartonin do më premtoni që do jeni të gjithë pjesmarrës.

Japim një javë kohë për rregullimin që ne të vendosim për mbledhjen jashtë rradhe.

Mbledhja leret në datën 10.11.2025. në orën 12:00

U votua

Pro 25

Kundër 0

Abstenim 0

Jo

Miratohet Po



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 31.10.2025

-Për rishqyrtimin e vendimit nr. 86, datë 25.09.2025, "Përmiratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistikë dhe sportive", i kthyer me shkresën e prefektit të qarkut korçë nr. 900/1 prot, datë 08.10.2025, me lëndë, "Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të këshillit".

Znj.Kryetare: Vazhdojmë me Projekt-Vendimin e rradhës.

Znj.Oparaku: Nga kërkesa që na dërgoi Prefektura bëmë ndryshimet përkatëse dhe e sollëm sërish për miratim.

Znj.Kryetare: Ne nuk folëm për gabimet drejtshkrimore, por folëm për formën si ishte hartuar Projekt- Vendimi. Shprehem që po e miratojmë me kushtin që do rregullohej , të refleктоhej dhe të bënin edhe ndryshimet në formë. Rregullorja e ndryshuar që ne kemi sot në duar erdhi që atë ditë, por unë nuk mund të vendosja vetë pa ju. Ishte komplet ndryshe nga rregullorja e parë. Unë nuk mund të firmosja pa me dhënë ju autorizimin për këtë ndryshim.

Tani rregullorja është e ndryshuar janë reflektuar të gjitha ndryshimet e nevojshme. Ju ftoj ta miratojmë.

Znj.Biba: Më fal znj.Kryetare prandaj ne nuk duhet të tolerojmë dhe të miratojmë, të jemi të përgjegjshëm dhe nuk është nevoja që të shkonim deri atje. Të ishte kthyer që atë ditë të ishte bërë kjo që duheshe bërë dhe të vinte prap në mbledhjen e rradhës. Sepse dhe rregullimi nuk ishte rregullim. Ju lutem mos ndodhin më këto, për hir të përgjegjësisë që ne kemi.

Znj.Kryetare: E hedhim për votim.

U votua

Pro 25

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 31.10. 2025

-Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Pogradec, për vitin 2026.

Znj.Kryetare: Ja japim fjalën drejtoreshës së Taksave dhe Tarifave Vendore për të na folur mbi projekt – vendimin.

Znj.Enjela: Takohemi përsëri për hartën e vitit 2026 e cila nuk ka ndryshime, pra është përsëri e njëjta. Të vetmet ndryshime janë pasi kanë mbaruar kontratat 5 vjecare, I kemi kthyer në të menaxhueshme për të riaplikuar sërish.. Kontrollohet që në 1000m linear 300m të jenë publike. Tani kërkojmë miratimin tuaj. Aplikimet fillojnë tani në Nëntor.

Znj.Kryetare: Meqë jemi këtu mund të na thoni kur fillojnë dhe kur mbarojnë aplikimet

Znj.Enjela: Nuk kanë dalë akoma sepse ne presim VKM. Kemi kërkuar si Bashki të bëhen disa ndryshime për shkak se në Njësisë Administrative Hudënisht nga zona nga fundi I Vilave deri sa shkojmë në Volorekë nuk ka hotele, tju jepet e drejta edhe bar restoranteve që kanë mbi 20 tavolina të shfrytëzohen nga ata.. Nga takimet që kemi realizuar me Ministrin e ri kemi mar Ok dhe presim që ajo të psqyrohet në VKM . Pas daljes në VKM menjëherë fillon aplikimi besoj qe do fillojmë nga data 15 Nëntor deri më 15 Dhjetor ashtu si u realizuan aplikimet edhe vjet. Ne zbatojmë VKM aktuale perderisa ajo është akoma në fuqi.

Znj. Kryetare: Hidhet në votim.

U votua

Pro 25

Kundër 0

Abstenim 0

Jo

Miratohet Po



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 31.10. 2025

Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 35.5200 ha, të ndodhura në Njësinë Administrative Cërravë që mund të jepen me qera.

Znj.Kryetare : Është një projekt- vendim të cilin e kemi diskutuar në dy mbledhje të kaluara, sot është e trera . Kam një përfaqësi banorësh të cilët kanë ardhur të flasin, ju japim fjalën ju lutem.

Z.Genci: Unë jam banor I fshatit Cërravë dhe fermer, ne jemi pyetur dhe përgjigjja jonë ka qënë negative për të vetmen arsye se ne po na u mor edhe ajo pjesë ne nuk kemi ku të kalojmë e ku të kullosim. Në të dyja anët të fshatit Cërravë, na I kanë zënë, po na morën edhe këtë ne kto që të jetojmë më ne Cërravë . X person erdhi mori një pjesë dhe pastaj përfundoi duke e zënë të gjithë e ka rrethua e ka bërë si ai ka dashur. Ju lutem të mos e votoni se ne as për ujë nuk do kalojmë dot dhe janë të vetmet kullota fshati që kanë ngelur. Ju lutem ju Këshilltarë të mos e votoni se do na merni në qafë, nesër,pasnesër do na dalë rroja dhe ne do kemi problem ashtu sic kemi problem me rrojen e anës tjetër. Kaq kisha , ju faleminderit.

Znj.Kryetare: Ju jeni I njëjti grup që ishit herën e kaluar.

Banorët: Po ne jemi I njëjti grup.

Z.Torra: Ne si Bashki shkuam edhe ke vëndi dhe takuam një pjesë të banorve, shpjeguam pozicionimin se ku këto parcela shtrihen. Pjesa ku banorët kishin problem që ishte pjesa e kullotës ne nuk e kemi sjellë e kemi hequr. Në këtë Projekt-Vendim që ne kemi sjellë janë dy pjesë të vogla të cilat nuk kanë interes për zhvillim të madh. Ne për zhvillim kemi sjellë vetëm 348 dhe 84-2 ndërsa 67 dhe 68 nuk mund të jenë pjesë. Nesër banorët mund të jenët të interesuar për këto pjesë. Ne mendojmë të kalojë në parim edhe të diskutohet.Dua të sqaroj edhe dicka tjetër ju jeni në dijeni për paketën e maleve kush të dojë dhe është I interesuar mund të hyjë dhe të aplikojë. Theksoj se në të gjitha këto lloj prona nuk është shprehur interes nga ana e banorëve , domethënë këta banorë mund të



jenë shumë të interesuar që të rinë nëpër toka, por nuk janë të interesuar që kjo pronë të zhvillohet. Ne nuk mund të presim pafundësisht dhe përgjigje, Prandaj unë I propozoj Këshillit pronat janë të Bashkisë dhe ne ta miratojmë.

Banori I Zonës: Domethënë I bie që ato toka edhe paketën e maleve ne do ti marrim si fshat.

Z.Torra: Interesohuni.

Banor I zonës: Në momentin që ne u bëmë gati të paguhet taksa ne morëm vesh që u vendos prap në mbledhje.

Z.Kryetare: Zotërinj kujdes po ngateroheni po flasim për pjesën tjetër.

Banor I zonës: Më vjen keq kullotë është edhe ajo, se I ndërroni emra dhe I vini ashtu si ju dëshironi. Erdhen dhe ne ju thamë ja ku I keni bagëtitë, por jo ne duhet të zemë këtë të zemë atë. Ju lutem mos votoj Këshilli se po votoi Këshilli I morët të gjitha.

Znj. Kryetare: Jo nuk mund ti marim të gjitha sepse këtu janë specifikuar.

Banor I zonës: I pamë edhe me të tjerët erdhen për një pjesë të vogël dhe kanë zënë komplet

Znj.Kryetare: Bashkia nuk mund të japë me qira toka që nuk janë të përmëndur tek ky Projekt- Vendim që ne kemi në dorë. Këto janë edhe me certifikatë, kullotat ishin një Projekt-Vendim tjetër që Këshilli u tërhoq. Të paktën unë kështu e kuptoj.

Banor I zonës: Edhe tek kjo nuk duhet të votojë Këshilli pikërisht për këtë arsye, se bëhët fjalë për atë zonë të vogël.

Znj.Kryetare: Kush do të marë fjalën.

Z.Qeva: Si është më mirë të ndihmojmë banorët e Cërravës apo të ndimojmë ata Tiransit. E mori Cerravën skemi parë gjë e mori Grabovicën as një lloj gjëje skan bërë, as një llojë ndihme fshatarëve edhe si mund ti votojmë ne këto gjëra.



Znj.Kryetare: Vota është një gjykim personal dhe secili nga ne ka të drejtë ta gjykojë vetë.

Z.Male: Këto janë Projekt-Vendime të diskutuara dhe shumë të debatuar.

Znj.Kryetare: Po e thamë është hera e tretë që vjen dhe diskutohet.

Z.Male: Ne para dy ditësh na thanë që kanë shkuar në zonë dhe kanë folur me banorët pikërisht për këto sipërfaqe që ne po diskutojmë këtu, por nuk qënkerka aspak e vërtetë sepse ja ku I kemi banorët dhe ata janë në kundërshtim .Ajo që më shqetëson gjithashtu sepse argumentat janë dhënë edhe nga ju edhe një argument tjetër në vitin 2023 Komiteti I Investimeve Strategjike ka vendosur për të mos dhënë 139 ha midis njësisë Administrative Cërravë dhe Bucimas dhe argumenti ka qënë ky. Zona e projektimit me sipërfaqe nuk ka një rregjistër fillestar në kadastër dhe tjetra që projekti I propozuar është në mospërputhje. Cdo Projekt- Vendim për parqet fotovoltaike duhet të ketë të bashkangjitur përputhshmëri me planin vendor. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Pra nuk është miratuar nga Ministria. Këtu na është thënë shpesh herë nga Sekretari I përgjithshëm po nuk është ashtu sic duket.

Znj.Kryetare: Më fal ky dokumenti që ju posidoni që të jemi terësisht transparent për kolegët, ku e keni gjetur?

Z.Male: Mund ta gjeni kollaj edhe ju dhe mund ta vendos në dispozicionin tuaj, për ta mbyllur unë jam kundërr dhe ju bëj edhe thirrje për të mos e votuar.

Z.Qeva : Ne nuk na lejon as ligji për ta bërë këto projekt.

Znj.Prifti: Ky është një Projekt- Vendim që ka paraqitur shumë pakënaqësira dhe problem dhe është hera e disat që vjen tek ne. Unë ju kërkoj të gjykojmë saktë sepse ne kemi bërë një betim kur kemi marrë mandatin e Këshilltarit. Unë e shoh të arsyeshme që ne ti mbështesim banorët.

Z.Torra: Të sqaroj pak për pozicionin sipas Kryetarit të përgjithshëm problem I investitorit strategjik ka qënë. Ka fillur nga Bashkia që ne të shpreheshim me sipërfaqen që ata kanë kërkuar, ata kanë kërkuar një sipërfaqe shumë herë më të madhe, por ne e kemi kundërshtuar këtë, kemi marrë ne këtë vendim dhe pastaj ka marrë Kryeministri këtë vendim. Nuk është e vërtetë që ai e ka marrë me mendjen e tij këtë vendim. Disa institucione të tjera kanë qënë pro për tu zhvilluar



zona. Sot ne jemi në kushte të tjera kjo sipërfaqe nuk ndikon absolutisht në as një lloj ndikimi.

Znj.Kryetare: Sqarojmë edhe dicka tjetër që tha:

Z. Torra: Ju keni një vendim që shpreh interesin për marrjen me qera ato nuk mund të bëhen kurrë fotovoltaike sepse ligji nuk të lejon nqs komuniteti I këtyre tokave është mbi 6, atje nuk lejohet të zhvillohet veprimtari tjetër përvec asaj buqësore. Kur komuniteti I këtyre tokave është 7-8 lejohet fotovoltaike që të sqarohet edhe dicka tjetër meren analizat dhe më pas e cakton Ministria e Buqësisë.

Znj.Marjeta: Janë kryer këto analiza të nevojshme që të jemi edhe ne të infomuar.

Z.Torra: Jo sepse ne do nxjerrim shpalljen edhe pjesmarrësi qe do vijë sipas bonitetit caktohen.

Z.Gjona: Për këtë pjesën që thotë Z. Nexho ketu thotë që është për buqësore pse e përmënd fjalën Bonitet. Unë kuptoj që pasi të jepet leja ajo mund të përdoret për gjera të tjera kurse ne projekt – vendim thotë që është për buqësinë .E dyta ,thuhet që banorët nuk duan ta zhvillojnë këtë tokë, banorët aty kanë kohë që e zhvillojnë këtë tokë, por e zhvillojnë në buqësi se atë bëjnë.

Z.Torra: Unë po të them që ka që në muajin Maj Paketa e Maleve dhe as nje nuk ka kërkuar interes, si do ta zhvillojnë kur nuk kanë interes. Pronën e administroni ju unë po vij me propozimin.

Znj.Kryetare ja japim fjalën banorit ju lutem prezantohu.

Z.Lulëzim : Jam banor I fshatit Cërravë kam 28 vjet që merem me blektori, zotëria në fjalë thotë që ska interes , ndërkohë kam 28 vjet që e shkel cdo pëllëmbë atë tokë,atje kullosin 4600 krerë.

Znj.Marjeta: A I paguani ju detyrimet përkatëse?

Z.Lulëzim: Sa shkuam ti paguajmë ne morëm vesh që ju e sollët prap në mbledhje për cfarë arsye ne duhet ti paguajmë këto detyrime, per te na marë tokën.

Banor I zonës: Para 11 vjetësh ne nuk e morëm vesh Z. Kryetare se si u bë,u votua su votua ne nuk e dimë akoma vetëm kur erdhën dhe e zunë edhe rrugën që ne kalojmë nga mali në krahun tjetër e bllokuan me rrjetë edhe ne nuk dimë se cfar bëhet aty. Kështu do ndodhi edhe me krahun tjetër që ju do e jepni .Po ju them që do na dalin me armë dhe do na thonë do largoheni. Se ata thonë ma ka dhënë këshilli mua

Znj.Kryetare: Atëhere kolegë e hedhim në votim.

U votua

Pro 15

Kundër 9 (Arbër Male) (Klajdi Gjona) (Albana Prifti) (Anila Gjoshe)
(Marjeta Biba) (Ylli Kasmollari) (Deogjen Qeva) (Genci Zyferi) (Liri Seitllari)

Abstenim 1 (Jovan Shkëmbi)

Po

Jo

A handwritten signature in black ink, appearing to be the initials 'JB' or similar, located in the bottom right corner of the page.

Mbi dhënie shpërblim për nxënësit ekselentë që kanë përfunduar arsimin e mesëm në vitin shkollor 2024-2025.

Z.Marsida: Për vitin shkollor 2024-2025 kanë dorëzuar dokumentacionin 12 nxënës. Kriteri i vendosur është mesatarja mbi 9.8. Tre nxënës të tjerë kanë dorëzuar dukumentat por ndërkohë mesatarja ka qënë nën kriterin e përcaktuar. Fondi është i njëjtë si vitin e kaluar.

Z.Shyti: A është fondi?

Znj.Kryetare: Ne e diskutuam dhe në komisione dhe ju lutem në momentin që janë të vendosura disa kriteret, nuk kemi të drejtë të pranojmë as nje dokument që nuk plotëson kriteret përkatëse. Na vjen shumë keq sepse ne jemi të hapur për të gjithë nxënësit, por kriteret janë kriteret.

Znj.Marjeta: Duke qënë e profesionit do ju thoja që më mirë mos i sillni fare, emrat që janë jashtë kriterit.

Znj.Kryetare: Ka ardhur projektvendimi por gjithashtu edhe ndarja e vlerës monetare ashtu sic e kemi përcaktuar.

E hedhim në votim edhe të keni parasysh edhe sygjerimin për vitin tjetër.

U votua

Pro 25

Kundër

Abstenim

Miratohet PO **JO**



Mbledhje e Këshillit Bashkiak
10. 2025

Pogradec më 31.

Për një shtesë në vendimin nr 56, datë 19.06.2023 “ Për krijimin e komisioneve të përhershme të këshillit të bashkisë Pogradec”

Znj.Pengu: Këtu kemi një ndryshim sepse të gjithë në muajin Mars kemi miratuar planin, por me ndryshimet Ligjore ne jemi të detyrueshëm të vendosim edhe një komision shtesë. E gjithë Shqipëria jo vetëm Pogradeci mbështet Diasporën edhe emigrantët dhe për këtë arsye ne e kemi parë të nevojshëm të ngrejmë edhe një komision pikërisht për ta. Ne i kemi shtuar komisionit shtesë edhe këto komisione. Komisioni do të shqyrtojë të gjitha vendimet që ne do të marim për këtë fushë. Qëllimi ynë është të integrojmë të gjithë ata që kanë dëshirë të kthen dhe ne të jemi krahë tyre. Më kryesorja është pse të mos promovojmë investimin e Diasporës.

Znj.Kryetare: Jeni dakort të votojmë, hidhet në votim.

U votua

Pro 25

Kundër

Abstenim

Miratohet

PO

JO



Mbledhje e Këshillit Bashkiak
31. 10. 2025

Pogradec më

16.Pika:Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025.

Znj.Irsa :Ka të bëjë me një shtesë në buxhet të sektorit të Zjarfiksëve. Ju jepet një shpërblim për punën që ata kryhen gjatë periudhës së rënieve të zjarreve. Është një fond që vjen nga Ministria.

Znj.Kryetare:I falenderojmë edhe I vlerësojmë për punën që kanë bërë gjate periudhës së zjareve. Hidhet në votim.

U votua

Pro 25

Kundër

Abstenim

JO

Miratohet PO



Mbledhje e Këshillit Bashkiak
31. 10. 2025

Pogradec më

Per akordimin e ndihmës financiare per familjen e z.Fatos Sulka, për mbulimin e shpenzimeve te varrimit, per humbjen e jetes se bashkeshortes Shpresa Sulka

Znj.Kryetare: Ngushëllime I urojmë familjes. Vazhdojmë e hedhim në votim.

U votua

Pro 25

Kundër

Abstenim

Jo

Miratohet Po



Mbledhje e Këshillit Bashkiak
31. 10. 2025

Pogradec më

“ Për miratimin në parim të dhënies në përdorim, të tubacioneve nëntokësore, për shtrirjen e linjave nëntokësore telefon, energji, tv kabllor, internet.

Znj.Kryetare: Për afat kohor këtë Projekt –Vendim po e shtyjmë për mbledhjen jashtë rradhe se nuk mundëm ta studiojmë.

E deklaroj mbledhjen e mbyllur.

Protokelli

Punonjese Sekretariatit

Suela Hentkula

Muratori Sekretare e
Këshillit



Argumentim ligjor për domosdoshmërinë e zhvillimit të konsultimit publik nga Këshilli Bashkiak për projektvendimin e parkut eolik

Në lidhje me projektvendimin "Për miratimin e dhënies në përdorim të fondit pyjor/kullosor, për ndërtimin e Parkut Eolik në Bashkinë e Pogradecit nga shoqëria 'RENX Albania' sh.p.k.", vlerësohet se është e domosdoshme zhvillimi i një procesi të ri konsultimi publik nga Këshilli Bashkiak, pavarësisht se administrata e bashkisë ka realizuar një konsultim publik më herët.

1. Baza ligjore

- **Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"**
 - **Neni 17, pika 1:**
"Organi i qeverisjes vendore ushtron funksionet dhe kompetencat e veta në mënyrë të hapur, transparente dhe me pjesëmarrjen e publikut, sidomos për çështje që kanë ndikim në interesin e përgjithshëm të komunitetit."
 - **Neni 18, pika 1 dhe 2:**
Parashikon të drejtën e qytetarëve për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse të organeve të qeverisjes vendore, përfshirë këtu edhe konsultimet publike të zhvilluara nga këshilli bashkiak.
- **Ligji nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"**
 - **Neni 7, pika 1:**
"Çdo autoritet publik, gjatë përgatitjes së një akti me ndikim publik, është i detyruar të njoftojë dhe të sigurojë konsultimin publik të tij."
 - **Neni 11, pika 1:**
"Autoritetet publike janë përgjegjëse për organizimin dhe dokumentimin e procesit të konsultimit publik për aktet që ato përgatisin apo miratojnë."


2. Arsyetimi ligjor

Nga interpretimi i këtyre dispozitave, rezulton qartë se:

- Konsultimi publik i zhvilluar nga administrata bashkiake në fazën e përgatitjes së projektit ka karakter teknik dhe përgatitor, pra është në funksion të hartimit të projektvendimit dhe relacionit shoqërues.
- Këshilli Bashkiak, si organ përfaqësues i qytetarëve dhe organi që miraton aktin përfundimtar, ka detyrimin ligjor të zhvillojë vetë një proces të pavarur konsultimi publik me banorët dhe grupet e interesit, përpara miratimit të vendimit.

Ky detyrim buron nga fakti që secili organ publik është përgjegjës për konsultimin lidhur me aktet që ai miraton, sipas nenit 11 të Ligjit nr. 146/2014.

Për më tepër, neni 17 i Ligjit 139/2015 kërkon që vendimmarrja e këshillit bashkiak të bëhet me transparencë dhe pjesëmarrje efektive të publikut, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështje që prekin interesin publik dhe pasuritë publike, siç është përdorimi i fondit pyjor/kullosor në këtë rast.



3. Përfundimi


Në përputhje me kuadrin ligjor të sipërcituar, konsultimi publik i zhvilluar më parë nga administrata bashkiake nuk e përjashton dhe nuk e zëvendëson detyrimin e Këshillit Bashkiak për të zhvilluar konsultimin e vet publik.

Për këtë arsye, përpara miratimit të projektvendimit në fjalë, Këshilli Bashkiak i Pogradecit duhet të:

1. Publikojë projektvendimin në faqen zyrtare dhe në ambientet e bashkisë;
2. Ftojë publikun dhe grupet e interesit të japin komente dhe sugjerime;
3. Dokumentojë procesin e konsultimit dhe t'i bashkëngjisë materialet në dosjen e vendimit.

Ky veprim siguron respektimin e parimeve të ligjshmërisë, transparencës, pjesëmarrjes qytetare dhe legjitimitetit institucional të procesit vendimmarrës të Këshillit Bashkiak.

Manjola Kamolli



The image shows a handwritten signature in cursive script that reads "Kamolli". To the right of the signature is a circular official stamp. The stamp contains the text "KESHILLI BASHKIAK I POGRADECIT" around the perimeter and a central emblem, likely the coat of arms of the municipality.